

Sevdail Demiri, PhD¹

UDC: 070(=18:497.7):811.18`351(497.784)"1908"
070(=18:497.7):811.18`35(496.534)"1972"

**KONGRESI I MANASTIRIT (1908) DHE KONGRESI I
DREJTSHKRIMIT (1972), NË FOKUSIN E SHTYPIT SHQIPTAR
TË MAQEDONISË (1945-1990)**

**БИТОЛСКИОТ КОНГРЕС (1908) И КОНГРЕС НА
ПРАВОПИСОТ (1972), ВО ФОКУСОТ НА АЛБАНСКИОТ
ПЕЧАТ ВО МАКЕДОНИЈА (1945-1990)**

**THE CONGRESS OF MANASTIR (1908) AND THE SPELLING
CONGRESS (1972), IN THE FOCUS OF THE ALBANIAN PRESS
IN MACEDONIA (1945-1990)**

Abstract

The history of the Congress of the Alphabet of the Albanian Language in Manastir (1908) and the history of the Congress of the Spelling of the Albanian Language in Tirana (1972), have also been in the focus of the Albanian press of Macedonia (1945-1990). During that period of heavy ideological burdens for the communist Yugoslavia, well-known scholars of Albanian knowledge, dealt extensively with these major topics for the cultural history of the Albanians.

During that period, the only print media in Albanian language that was published in Macedonia was the newspaper "Flaka e Vëllazërimit" (The flame of brotherhood) with its magazines "Jehona" (Echoes), "Fatosi" (primary school pupil) and "Gëzimi" (joy). Cultural-historical topics were often published in them by different and well-known authors, which elaborated on the problems of the alphabet and spelling of the Albanian language.

¹ Autori është doktor i shkencave historike, këshilltar shkencor / profesor i rregullt në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, dhe ligjërues i angazhuar në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup. E-mail: sevdaildemiri@yahoo.com

These Albanian print media in Macedonia became the vanguard of the use of the spelling of the Albanian language, playing a very important role in the cultural and national emancipation of the Albanians here. Despite the state borders that separated us, the Albanians in Skopje positioned themselves together with Prishtina and Tirana in the creation of a unified language standard, as the only means of communication despite the artificial divisions between state made at the end of the Second World War.

In this paper we will highlight some topics of interest that have been elaborated in the Albanian press of the time in the Republic of Macedonia, and more specifically some of the papers published in the newspaper "Flaka e vellazerimit" and its magazines.

***Keywords:** newspaper, magazine, congress, alphabet, spelling, Manastir, Skopje, Tirana*

Hyrje

Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe i njohur ndryshe si Kongresi i Manastirit (1908), sikurse edhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë (1972), përbëjnë dy ngjarje madhore në historinë kulturore të kombit shqiptar. Derisa me të parën u dha orientimi i qartë evropian dhe properëndimor i shqiptarëve, me të dytën u rrumbullakua procesi i kombndërtimit me gjuhën shqipe si elementi themelor i bashkimit të shqiptarëve në rrethana kur kufijtë na ndanë padrejtësisht në shumë shtete.

Me Kongresin e Manastirit të vitit 1908, filloi një erë e re edhe e shtypit dhe publicistikës shqiptare. Me themelimin e shoqërisë "Bashkimi" në Manastir dhe shumë klubeve të ngjashme nëpër qytete të ndryshme të shqiptarisë dhe sidomos me themelimin e shtypshkronjës me të njëjtin emër, u bë një revolucion i paparë deri në atë kohë, në afirmimin e identitetit shqiptar në korniza ballkanike dhe evropiane. Rilindja Kombëtare Shqiptare, gjeti shtratin e vetë të vërtetë, pikërisht në suaza të organizimit të mirëfilltë politik, shoqëror, kulturor dhe arsimor që bënë këto klube shqiptare, rreth të cilave ishin mbledhur atdhetarët më në zë të kombit.

Në të vërtetë, me Kongresin e Manastirit, u krijuan kushte të reja edhe për veprimtarinë e shtypit. Me vendim të kongresit, u formuan klube shqiptare me karakter kulturor e arsimor në dhjetëra qytete

shqiptare, si dhe sigurohet një shtypshkronjë solide për kohën, në të cilën u shtypën gazeta, revista e libra në gjuhën shqipe. Në këtë shtypshkronjë me emrin “Bashkimi”, u shtypën gazetat e para shqipe në territorin e sotëm të Maqedonisë, dhe të njëjtat u shpërndanë nëpër qendrat kryesore shqiptare në Ballkan dhe diasporë. Kështu, në periudhën e viteve 1909-1911, aty u shtyp gazeta “Bashkimi i Kombit”, më vonë, në vitet 1911-1912 u shtyp gazeta “Drita”, gazeta “Shkupi” me qendër në Shkup në vitet 1911-1912, revista “Lahuta e Malcis” më 1911. Në po të njëjtën shtypshkronjë u përgatitën kalendarët “Afërdita” (1910), “Dija” (1910-1911) dhe “Korça” (1911-1912).

Nga të gjitha këto organe të shtypit të asaj kohe, gazeta me një rëndësi të madhe për historinë e gazetarisë shqiptare në Maqedoni dhe për historiografinë shqiptare në përgjithësi, është gazeta “Shkupi”², numri i parë i të cilës u botua më 29 gusht të vitit 1911 në Shkup, nën redaktimin e gazetarit të njohur dhe rilindësit, Jashar Erebara.

Fatkeqësisht, kjo periudhë e ndritshme zgjati fare pak, për të hyrë në një fazë të errët të historisë sonë, me pushtimin që bëri Serbia ndaj këtyre territoreve, e deri në Luftën e Dytë Botërore, pas së cilës, megjithatë pati edhe ca lëvizje të vogla pozitive në këtë drejtim.

Prej 4 prillit të vitit 1945, në Shkup filloi të botohet gazeta “Flaka e Vllaznimit”, të cilës më vonë do t’i shtohen edhe revistat për fëmijë “Gëzimi” e “Fatosi”, si dhe revista për shkencë, kulturë, art dhe letërsi “Jehona”. Këto organe të vetme të shtypit shqiptar në Maqedoninë socialiste jugosllave, përkaj kushteve shumë të vështira të kohës (teknike, kadrovike dhe shoqërore-politike), dhanë një kontribut të çmuar në zhvillimin tonë kulturor e arsimor.

Deri në paraqitjen e pluralizmit politik në vitet e ’90-ta të shekullit të kaluar, gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, bashkë me revistat “Fatosi”, “Gëzimi” e “Jehona”, ishin organet kryesore të shtypit shqiptar në Maqedoni, me një numër të lakmueshëm lexuesish. Por, fatkeqësisht, me paraqitjen e demokracisë dhe mediave të lira, u shuan këto tre media të shtypura, të cilat megjithatë ende merren si referenca kryesore për shumë ngjarje kulturore e historike për shqiptarët e Maqedonisë në periudhën komuniste gati se gati pesëdekadëshe.

Rrjedhimisht, në këto organe të shtypit shqiptar në Maqedoni, çështja e Kongresit të Manastirit (1908) dhe e alfabetit të tij unifikues,

² Gazeta “Shkupi”, e cila botohej në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës (Shkup), konsiderohet publikimi i parë periodik në gjuhën shqipe edhe në Kosovë. Shih: Sherafedin Hoxha, Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës (1871-1983), Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 67.

dhe më vonë edhe çështja e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) që u mbajt në Tiranë, kanë qenë tema të trajtuara kënaqshëm. Për to kanë shkruar shumë historianë, gjuhëtarë e gazetarë, të cilët në forma të ndryshme i kanë përkujtuar këto ngjarje madhore për historinë kulturore të kombit shqiptar.

Pasqyrimi i Kongresit të Manastirit

Kryeredaktor i parë i gazetës “Flaka e Vllaznimit” ishte emëruar Petro Janura, i cili shërbeu edhe si drejtor i saj deri në vitin 1946. Petro Janura (1911-1983), i cili konsiderohet se ishte me origjinë arumunë³ (vllahe), i lindur në Fier të Shqipërisë, ishte intelektual i shquar, shkencëtar dhe profesor universitar. U shkollua në Shqipëri, Rumani e Itali dhe gjatë LDB-së mbeti në Maqedoni, ku la gjurmë të thella në zhvillimin e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Përpos kontributit në themelimin e gazetës “Flaka e Vllaznimit”, ai ishte edhe një nga themeluesit e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shkupit, si dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972 në Tiranë.

Dr. Petro Janura botoi në vazhdimësi një sërë tekstesh të natyrës kulturo-arsimore, të cilat patën jehonë shumë pozitive në opinionin lexues shqiptar jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë ku shpërndahej gazeta nëpër ish-Jugosllavi. Në gazetën e datës 2 gusht 1954, duke shkruar për historikun e gjuhës shqipe, boton tekstin me titull: “*Pak fjalë mbi zanafillën dhe evolutën e alfabetit të shqipes*”. Përmes këtij teksti, Janura jep një leksion shumë me interes lidhur me historikun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, i cili kaloi shumë faza të vështira gjatë evoluimit të tij deri në atë kohë. Rol të veçantë do t’i kushtojë Kongresit të Manastirit të vitit 1908, ku u vunë themelet e alfabetit të unifikuar shqip.

Megjithatë, më së tepërmi kësaj teme i jepet rëndësi gjatë vitit 1968, me rastin e shënimit jubilar të 60-vjetorit Kongresit të Manastirit, kur edhe për herë të parë, kjo ngjarje u shënua në mënyrë institucionale në Maqedoni dhe u vu pllaka përkujtimore në nderim të kësaj ngjarjeje, pikërisht në ndërtesën ku sot funksionon Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir.

Konkretisht, më 22.11.1968, gazeta “Flaka e Vëllazërimit” informon për shënimin e 60-vjetorit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe, me

³ Gazeta “Fraqia/Vëllazëria”, 11-12, 2014, Shoqata “Arumunët e Shqipërisë”, Tiranë, f. 6.

titullin: “*Në Manastir u zbulua pllaka përkujtimore*”. Në këtë jubile të madh, i cili përkonte edhe 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në qytetin e Manastirit ishte zbuluar pllaka në Shtëpinë e Alfabetit, dhe për rëndësinë e këtij evenimenti, para një numri të madh mysafirësh nga Shkupi dhe Kosova, kishte folur kryetari i këshillit organizativ të këtyre dy datave, shkrimtari Vllado Malevski. Ai në fjalën e tij, veç tjerash kishte thënë: “*Në ditën e sotme, përpara 60 viteve, në ndërtesën përpara së cilës jemi tubuar, është mbajtur Kongresi i njohur i Manastirit, në të cilin patriotët shqiptarë morën një vendim historik për popullin fqinj shqiptar - formuan alfabetin unik të gjuhës shqipe. Me këtë datë fillon historia e fjalës së shkruar bashkëkohore shqipe...*”⁴.

Pas fjalimit inaugurues para Shtëpisë së Alfabetit, të pranishmit u ishin drejtuar varrezave të qytetit të Manastirit dhe mbi varrin e familjes Qiriazit, ishin vënë kurora lulësh nga përfaqësues të Këshillit për kremtim, Këshillit të kuvendit të Manastirit dhe redaksisë “Flaka e Vëllazërimit”.

Kur jemi te kjo gazetë dhe te kjo temë, po përmendim një tjetër material “problematik”, që botohet në një nga ballinat e “Flakës...” në janar të vitit 1989, me titull: “*Pllaka as u hoq, as do të hiqet*”, e që ka të bëjë me sqarimin e një dezinformate të plasuar nga agjencia e lajmeve “Tanjug”, për gjoja një vendim të komunës së Manastirit për heqjen e shenjës - pllakës përkujtimore në shtëpinë e Alfabetit të gjuhës shqipe në Manastir. Pas lajmit të dhënë, kishin pasuar një sërë reagimesh të ashpra, sidomos nga institucionet kulturore dhe arsimore të Kosovës, të cilat e dënonin një akt të tillë. Në një deklaratë për gazetën, kryetari i atëhershëm i kuvendit komunal të Manastirit, Jovan Avramovski, kishte deklaruar se “*Kuvendi nuk ka diskutuar dhe nuk ka marrë vendim që të hiqet pllaka, por se bëhet fjalë për një dezinformatë*”⁵. Të përkujtojmë se periudha në fund të viteve të 80-ta, kur po shfaqeshin shenjat e para të prishjes së federatës jugosllave, ishte shumë e ndjeshme për të gjithë shqiptarët nën Jugosllavi, e në veçanti në ato vende ku shqiptarët ishin pakicë, siç ishte rasti me qytetin e Manastirit.

Një material interesant historik do të lexojmë në faqet e “Flakës...” në nëntorin e vitit 1974, me rastin e shënimit të 65-vjetorit të shtypshkronjës së parë shqiptare në Manastir. Titulli i artikullit është “*Prej Bashkimit të Kombit, deri në vendimet e ASNOMI-t*”⁶. Autori i

⁴ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 22.11.1968

⁵ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 11.01.1989

⁶ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 22.11.1974

tekstit Dimitar Dimitrovski, jep një version të gjerë të historikut të kësaj shtypshkronje, e cila i shtypi librat dhe botimet e para të Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, gazetën shqiptare “Bashkimi i Kombit”, e deri në periudhën e re dhjetëra vite më vonë, ku po nga kjo shtypshkronjë shqiptare u shtypën disa nga vendimet e ASNOM-it, e cila llogaritet si themeltare e shtetit të ri maqedonas pas Luftës së Dytë Botërore. Teksti mbështetet nga burime historike, por edhe nga rrëfimet dhe kujtimet e Kristo Qiriazit, njërit nga pinjollët e familjes Qiriazit, e cila mori pjesë në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj shtypshkronje.

Po i kthehemi sërish vitit 1968, por tani përmes prezantimit të çështjes së Kongresit të Manastirit në revistën për shkencë, kulturë, art dhe letërsi “Jehona” që botohej po ashtu në Shkup.

Meqë në atë kohë ende nuk kishte një gjuhë të standardizuar shqipe, gjatë pasqyrimin të materialeve të saj, revista në tekstet e saj të botuara përdorte më tepër dialektin gegë, e herë-herë të përzier edhe me atë toskë, varësisht nga ligjërimi i autorit, por megjithatë nuk largohej shumë nga shqipja bashkëkohore, e cila do të konstituohej dhjetë vjet më vonë në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972.

Revista “Jehona” në numrin e saj 4-5/1968, sjell punimin e autorit Burhan Shukriu me titull: *“Edhe një përvjetor për shqiptarë”*, që i kushtohet konkretisht Kongresit të Manastirit. Autori jep një pasqyrë të përdorimit të alfabeve të ndryshme gjatë shkrimit të gjuhës shqipe, si dhe përpjekjet e mëdha të atdhetarëve shqiptarë deri në unifikimin e plotë të alfabetit të sotëm të shqipes. Në këtë punim, autori do të theksojë, se: *“Kongresi i Manastirit shënon një ndër datat më të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare. Ai qe vendimtar për fatin e alfabetit të shqipes letrare dhe për krijimin e inteligjencës shqiptare që kemi ne sot”*⁷.

Një tjetër material me interes që lidhet me këtë temë, është punimi i historianit të njohur Muhamet Pirraku, botuar në revistën “Jehona” po ashtu gjatë vitit 1968, me titull: *“Prej tipologjisë, deri te shtypshkronja internacionale”*. Në këtë punim, autori nis me rëndësinë e Shoqërisë së Stambollit për shtypjen e shkronjave shqipe, që udhëhiqej nga rilindësit e njohur Sami Frashëri, Pashko Vasa e të tjerë. Sipas tij, në këtë organizim e ka zanafillën alfabeti shqip me shkronja latine. Më tej jep historikun e zhvillimit të kolonive shqiptare në botë, të cilat patën një aktivitet shumë të ngjeshur botues, me qëllim ndërgjegjësimin kombëtar të popullatës shqiptare. Historini Pirraku ndalet posaçërisht në Kongresin

⁷ Revista “Jehona”, Shkup, 4-5/1968, f. 86-91

e Manastirit, dhe aktivitetet e patriotëve shqiptarë për themelimin e shtypshkronjës “Bashkimi i kombit”. Autori potencon se kjo shtypshkronjë u themelua nga Kristo Qiriaz, Feim Frashëri, Gjergj Qiriaz, Fehim Zavalani e 7-8 veta të tjerë. Sipas citatit të kujtimeve të Kristo Qiriazit në gazetën “Bitolski vesnik” (1964), shkronjat shqipe ishin porositur në një shkritore në Vjenë, prej ku gjithashtu ishin marrë edhe shkronjat për shtypjen e materialeve në 13 gjuhë të ndryshme, me çka shtypshkronja e Manastirit ishte bërë e vetmja e atyre përmasave në Ballkan dhe me karakter ndërkombëtar⁸.

Viti 1968 përmbillet për revistën “Jehona” edhe me një tjetër material shkencor, gjuhësor e historik të shkruar nga studiuesi Petro Janura. Në numrin 8-9 të revistës të atij viti, autori në fjalë botoi një tekst të gjatë me titull: “Panorama e alfabetit të shqipes”, ku që në fillim thekson se *“Rruga historike e alfabetit të shqipes ka qenë plotë me gjemba, ashtu siç ka qenë edhe vetë historia e shqiptarit”*. Këtu autori sjell informacione shkencore nga të gjitha periudhat e zhvillimit të alfabetit tonë, duke filluar që nga periudha ilire, kur mesapët përdorën një alfabet greko-etrusk të latinizuar, e deri tek alfabeti i Kongresit të Manastirit të vitit 1908. Sipas Janurës, ky alfabet u vu në zbatim në rrethana të vështira, edhe atë pa kurrfarë urdhërese administrative, por me ndërgjegjen e lartë kombëtare të shqiptarëve. Në fund të studimit, autorit thekson se: *“Alfabeti i Manastirit meriton të jetë i nderuar dhe i lavdëruar prej çdo shqiptari, që me të ka nisur të shkruaj emrin e vetë, të lexojë literaturën e mrekullueshme plot humanizëm, dhe historinë e ndritshme të tij plot me faqe të ndritura lufte ngadhënjimtare”*⁹.

Përveç gazetës “Flaka” dhe revistës “Jehona”, çështja e Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe është përfshirë në shumë përmbajtje edhe te revistat për fëmijë “Fatosi” dhe “Gëzimi”. Këtu dallohen disa punime letrare në prozë dhe poezi, por edhe tekste të shkurtra të autorëve të njohur shqiptarë të cilët i këndojnë alfabetit të gjuhës së bukur shqipe.

E shfletojmë “Fatosin” e vitit 1985, konkretisht numrin 1 të datës 15 shtator 1985, i cili para së gjithash i përkushtohet vitit të ri shkollor. Në këtë numër lexojmë një nga vjershat më të bukura të letërsisë shqipe për fëmijë, të cilën e di përmendsh çdo nxënës i klasës së parë “*Margaritarët e gjuhës*”, e që i kushtohet 36 shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe.

⁸ Revista “Jehona”, Shkup, 7/1968, f. 61-67

⁹ Revista “Jehona”, Shkup, 8-9/1968, f. 27-43

Pasqyrimi i Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë

Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, një kujdes të veçantë i kushtoi kultivimit të gjuhës letrare shqipe, e cila ende nuk i kishte marrë konkurat e duhura të drejtshkrimit. Kështu, duke përdorur moton kryesore të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (të mbajtur më 22-23 prill të vitit 1968), gazetari dhe gjuhëtari Xhevat Gega, shkruan artikullin me titull “Për një komb - një gjuhë letrare - një drejtshkrim”¹⁰. Kjo konsultë e organizuar nga Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhësisë e Universitetit të Prishtinës, dhe ku kishin marrë pjesë studiues të njohur të gjuhësisë, i kishte paraprirë Konferencës së Drejtshkrimit të mbajtur në Tiranë më 1972. Në këtë konsultë, ishin dhënë bazat e formimit të një drejtshkrimi të unifikuar, i cili do të përdorej në të gjitha trojet shqiptare dhe nga të gjithë shqiptarët kudo që gjendeshin.

Rëndësia e madhe që kjo gazetë po i jepte gjuhës shqipe dhe drejtshkrimit të saj, tregohet jo vetëm se në nivelin e lartë gjuhësor dhe të unifikuar që përdor, edhe pse ende nuk ishte mbajtur Kongresi i Drejtshkrimit (1972) në Tiranë, por edhe me leksione të ndryshme gjuhësore nga ekspertë të fushës. Kështu, gjatë muajit shkurt të vitit 1970, në disa vazhdimë do të lexojmë fejttonin e përgatitur nga Rexhep Zllatku, i cili përmes rubrikës me titull “Ç’thotë profesori i shqipes”¹¹, në të vërtetë bënë një bisedë të gjatë për problemet gjuhësore të shqipes me prof. Remzi Nesimin, i cili do të jetë njëri nga pjesëmarrësit e Kongresi i Drejtshkrimit. Rubrika në fjalë ishte e hapur edhe për lexuesit, të cilët kishin mundësinë të parashtronjë pyetje lidhur me këto tema dhe probleme profesionale gjuhësore.

“... Dhe nisëm me gjuhën e unjësuar”¹², është titulli i gazetës “Flaka...” e datës 23.3.1975, ku kryeredaktori i katërt i kësaj gazete, Lutfi Rusi, shpalos kujtimet e tij gjatë kohës sa ishte në pozicionin më të lartë drejtues, përkatësisht kryeredaktor. Në kohën derisa ai ishte në këtë pozicion (1965-1972), gazeta filloi të del nga tri herë në javë. Por, akoma më i rëndësishëm është fakti se kjo gazetë do të jetë nga të parat e cila do t’i bindet vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe që u mbajt në Tiranë në vitin 1972. Pra, që nga ky vit gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, në shkrimet e veta do ta përdorë me fanatizëm gjuhën e unifikuar letrare shqipe, e cila si e tillë filloi të aplikohet në të

¹⁰ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1.5.1968

¹¹ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, shkurt 1970

¹² Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 23.3.1975

gjitha trevat shqiptare, duke lënë pas dialektet dhe të folmet e ndryshme të cilat mund të haseshin deri në këtë kohë madje edhe nëpër medime dhe institucione të shtetit.

Në numrin vijues, më 30.3.1975, botohen kujtimet e kryeredaktorit të pestë me radhë të kësaj gazete, Sejfedin Sulejmani, me titullin “*Më të mira rezultatet se sa kushtet*”. Sulejmani ishte në krye të gazetës në periudhën 1972-1974, kur përpos fillimit të aplikimit të standardit të ri gjuhësor të shqipes (Sulejmani ishte vetë pjesëmarrës në punimet e Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë më 1972), do të ndodhin edhe disa ndryshime kushtetuese në federatën jugosllave. Sipas Sulejmanit, ekipi i vogël i gazetarëve dhe i redaktorëve punoi me zell dhe përkushtim të veçantë në realizimin e koncepteve të përcaktuara programore, dhe u bënë përpjekje të mëdha për rritjen e nivelit të gazetës dhe tirazhit të saj.

Realisht, edhe shumë tekste tjera të botuara në faqet e gazetës “Flaka...”, sikurse edhe në revistat rreth saj, dy temat tona kryesore (Kongresi i Manastirit dhe Kongresi i Drejtshkrimit) trajtohen gjerë e gjatë. Në veçanti është për t’u vlerësuar fakti që disa nga redaktorët e angazhuar nëpër këto organe të shtypit, ishin edhe vetë të kyçur në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjet gjuhësore. Petro Janura, Sejfedin Sulejmani, Remzi Nesimi ishin edhe pjesëmarrës të Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë, dhe ata e kishin mision përdorimin e gjuhës standarde në komunikimin publik. Në këtë mënyrë ata dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në emancipimin kulturor dhe gjuhësor të shqiptarëve që jetonin brenda Republikës së Maqedonisë. Prandaj, sado që vepruan në një sistem politik shtetëror që ishte diskriminues në shumë aspekte për shqiptarët, është për t’u vlerësuar kontributi i tyre në aspekt të zhvillimit dhe emancipimit kulturor dhe gjuhësor të shqiptarëve të këtushëm.

Conclusion

The issue of the Congress of the Alphabet of the Albanian Language in Manastir, as well as that of the Spelling Congress, have historically been kept alive, not only in the press, but also in the national consciousness of the Albanians. These events were recorded in different ways, with cultural-scientific activities, but also through notes in the only Albanian written media of the time, such as the newspaper "Flaka e Vëllazërimit" and its magazines - "Jehona", "Fatosi" and "Gëzimi".

Through the pages of these print media, well-known names have approached diverse topics. Some of the authors have written very

competently, not only journalistically, but also scientifically. The names of Petro Janura, Remzi Nesimi and Sefedin Sulejmani became known with their participation in the works of the Congress of Spelling of the Albanian Language in Tirana in 1972, and they were the most dedicated learners of the standard Albanian language. Therefore, we note that the main Albanian newspaper in Macedonia during the socialist period, "Flaka e Vëllazërimit", made a great contribution to the cultural and historical development of the Albanians in Macedonia and beyond, despite the ideological obstacles of the time (1945-1990).

Recensentë:

Prof. Dr. Skender Asani

Prof. Dr. Sefer Tahiri

Referencat:

Shtypi:

1. Gazeta "Flaka e Vëllazërimit", Shkup, 1945-1990
2. Revista "Gëzimi", Shkup, 1950-1990
3. Revista "Fatosi", Shkup, 1955-1990
4. Revista "Jehona", Shkup, 1962-1990
5. Gazeta "Fratëria/Vëllazëria", Tiranë, 2014

Literatura:

1. Hoxha Sherafedin, *Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës (1871-1983)*, Rilindja, Prishtinë, 1987;
2. Fevziu Blendi, *Histori e shtypit shqiptar 1848-2005*, Onufri, Tiranë, 2005;
3. Turkeshi Lutfi, *Historia e shtypit shqiptar (1908-1912)*, Vatra, Shkup, 2001;
4. Lita Qerim, *Naçertania – K.Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni 1945-1954*, Shkupi, Shkup, 2007;
5. SCUPI-10, *70-vjetori i botimit të gazetës "Flaka e Vëllazërimit"*, ITShKSh, Shkup, 2015.
6. Мокров Боро, *Развојот на македонскио печат и новинарство, од првите почетоци до 1945 година*, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Komunist, Shkup, 1980;